



Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.10.2019, Ora 10.00

Drejtojnë mbledhjen:

**Damian Gjijnuri dhe Rudina Hajdari – bashkëkryetarë të Komisionit të
Posaçëm të Reformës Zgjedhore**

Rendi i ditës

1. Diskutime lidhur me ecurinë e axhendës së punës së komisionit.
2. Konkluzionet e tryezës së organizuar nga OSBE-ja në datën 25 shtator lidhur me sistemin zgjedhor.

Marrin pjesë:

Damian Gjijnuri, Rudina Hajdari, Vasilika Hysi, Blerina Gjylameti, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Arben Elezi, Myslim Murrizi, Korab Lita, Nimet Musaj, Ralf Gjoni, Adriatik Alimadhi dhe Adnor Shameti.

Mungojnë:

Klotilda Bushka.

HAPET MBLEDHJA

Damian Gjicknuri – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e radhës së Komisionit për Reformën Zgjedhore, ku unë dua të bëj disa propozime për vazhdimin e axhendës për ecurinë e objektivave që i kemi vënë vetes në bazë të vendimit të Kuvendit. Kam diskutuar edhe me bashkëkryetaren në lidhje me ecurinë e këtij procesi.

Si pikë të parë të rendit të ditës, siç e keni pasur edhe në njoftim, kemi konkluzionet e tryezës së OSBE-ODIHR-it, si dhe vendimmarrjen tonë për t'jua dhënë juve, si opozitë parlamentare, iniciativën, meqenëse jeni shumë më të interesuar për sistemin zgjedhor, në mënyrë që të kemi një propozim tuajin të dakordësuar për sistemin zgjedhor, pra që të jetë një dokument pune i gatshëm për konsultim bashkë me të gjithë analizën racionale pse duhet zgjedhur ky ose ai sistem. Pastaj, duhet të diskutohet këtu në Komisionin për Reformën Zgjedhore.

Çështja e dytë në rendin e ditës është një çështje paralele, pasi është objekt i punës së Komisionit për Reformën Zgjedhore. Siç ramë dakord pas asaj tryeze, meqenëse nuk ka dakordësi se cili është sistemi (patjetër që ka mendime të ndryshme, sistemi edhe mund të shikohet, por ju takon juve. Këtë e themi, sepse kjo ka qenë edhe pjesë e marrëveshjes politike që në krijimin e Komisionit për Reformën Zgjedhore), do të vijmë me një propozim të konsoliduar.

E dyta, ne, ndërkohë, së bashku me ekspertët që kemi përzgjedhur, duhet të ecim paralelisht me paketën tjetër ligjore për sa u përket çështjeve, që kanë të bëjnë me administrimin zgjedhor, që janë rekomandimet e OSBE-ODIHR-it.

Unë propozoj që të ecim paralelisht, t'i diskutojmë, t'i miratojmë në parim, pastaj është çështje tjetër se kur do t'i çojmë për miratim në parlament për t'i bërë pjesë të Kodit Zgjedhor. Kjo gjë kërkon një proces diskutimi edhe konsensual, edhe përtej Komisionit për Reformën Zgjedhore. Por, të paktën, të ecim, pasi Shqipëria ka edhe detyrime, aq më tepër që jemi në prag të çeljes së negociatave, derisa të bëhet mbledhja e konferencës ndërqeveritare për ecurinë e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Europian. Ky proces është vënë ndër prioritetet e prioritetëve. Ndaj mendoj që çështjet teknike, të gatshme të OSBE-ODIHR-it (duhet thënë se është bërë edhe një punë e mirë nga komisioni paraprak), propozoj që të diskutohen në komision, të diskutohen më gjerë në një tryezë me shoqërinë civile me

pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve politikë, që t'i kemi gati si paketa, me qëllim që, kur të kemi konsensusin, t'i kalojmë për miratim në Kuvend.

Ky është propozimi im. Pra, mendojeni e koordinojeni vetë procesin e propozimit të sistemit zgjedhor dhe angazhohuni.

Së dyti, të vëmë një afat, t'ua lëmë ekspertëve, ndoshta për një javë.

Unë propozoj që, për shembull, çështjet si: barazia gjinore, financimi i zgjedhjeve, media në fushatën zgjedhore, çështjet e përdorimit të burimeve njerëzore në administratën shtetërore, si dhe amendimet e tjera të natyrës teknike të jenë një paketë e vetme dhe të sillen për diskutim sa më shpejt, ndoshta një javë kohë do ta duan ekspertët. Natyrisht, ata do të sjellin një produkt, i cili do të diskutohet në komision dhe, pasi ne të biem dakord, do të bëjmë edhe një konsultë më të gjerë së bashku me aktorët e tjerë edhe ndërkombëtarë, në mënyrë që ne të kemi një konsultim më të gjerë të këtij procesi.

Çështja e dytë, që është shumë e rëndësishme, është administrata zgjedhore deri në nivelin e KQZ-së, në qoftë do të ketë propozime edhe nga ju.

Pra, ideja e depolitizimit të administratës zgjedhore apo një formë balancimi, gjysmë depolitizimi. Kjo është një gjë që duhet diskutuar. Unë nuk po e jap opinionin tim për çfarë jam në favor, por, personalisht, mendoj se tendenca është të shkohet drejt administrimit të depolitizuar të zgjedhjeve. Edhe kjo është një gjë për të cilën ekspertët do të marrin kohën dhe do të na vijnë me disa propozime që ne do t'i diskutojmë më pas.

Kuptohet, ju keni përfaqësuesit tuaj te grupi i ekspertëve dhe, natyrshëm, shumë nga opinionet tuaja, dëshirat ose konceptet që keni për këtë proces mund t'i jepni aty që gjëja të dakordësohet në nivel ekspertësh dhe pastaj të vijë në Komisionin e Reformës Zgjedhore për miratim.

Me këtë ne arrijmë që paketën ligjore për adresimin e rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it ta kemi gati brenda fillimit të nëntorit. Pastaj janë çështjet e tjera më të hapura, si çështja e votës së emigrantëve, për të cilën nuk ka rekomandim; çështja e teknologjisë në zgjedhje, për të cilën përsëri nuk ka ndonjë rekomandim, si dhe çështja e sistemit zgjedhor, për të cilën është një kërkesë juaja politike e, natyrshëm, është për t'u trajtuar. Prandaj thashë që keni iniciativën për vazhduar me një propozim për të ardhur në Komisionin e Reformës Zgjedhore. Unë këtë propozoj për ecuri.

Së fundi, siç kam rënë dakord me bashkëkryetarin, të krijojmë edhe një nënkomision me 4 anëtarë për ligjin për financimin e partive politike, që të fillojë të punojë paralel. Nuk ka pse të konfondohet me këtë axhendë, mund të bëhet edhe pak më vonë. Mendoj se mund ta

ndajmë në dy faza për të adresuar edhe problemet e tjera. 2 anëtarë nga ne dhe 2 anëtarë nga ju të punojnë si grup në lidhje me ndryshimet ligjore për financimin e partive politike. Ne kemi donatorë që na mbështesin, është NDA-j, në mos gaboj, është edhe fondacioni britanik, të cilët janë të gatshëm të mbështesin dhe ka rekomandime në lidhje me financimin e partive politike. Kjo është një pjesë e rëndësishme, sepse doli edhe nga diskutimet, që u bënë në parlamentin gjerman, sepse ky është edhe një nga kushtet që Shqipëria duhet ta plotësojë.

Kështu që ne propozojmë 2 anëtarë: zonjën Blerina Gjylameti dhe zonjën Klotilda Ferhati. Rudina do të propozojë 2 anëtarë ose ju së bashku propozoni 2 anëtarë dhe ky grup të fillojë punën, që të ecë paralel dhe më pas, kur të kemi një produkt, bashkë me ekspertët ta diskutojmë në komision për të ecur përpara.

Të jap edhe një sqarim, meqenëse u ngrit pyetja: pse është bërë pa medie? Tradita e Komisionit të Reformës Zgjedhore për mbledhjet, që kanë qenë të natyrës vendimmarrëse, që lidhen me ecurinë e punës, kanë qenë të mbyllura. Pra, pa medie, jo se janë të mbyllura, sepse ato janë rekorde dhe do të bëhen publike të gjitha transkriptet për publikun e gjerë dhe për mediet. Por, kur të vijë diskutimi për draftet e caktuara dhe aty ku mund të kemi opinione të ndryshme, bashkë do ta vendosim, do ta bëjmë me medie dhe, natyrshëm, çdo njeri mund të mbajë qëndrime të natyrës politike. Kjo është për ecurinë e punës, në mënyrë që ne të ecim, sepse do të mbetemi pas dhe do të jemi jashtë atyre objektivave që i kemi vënë vetes.

Faleminderit!

Fjalën po ia jap bashkëkryetares, në qoftë se ka ndonjë gjë për të shtuar.

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Gjijnuri!

Mirëmëngjesi të gjithëve!

Së pari, duhet të them, zoti Gjijnuri, pa iu futur një tjetër konflikti, por ne ende nuk kemi rënë dakord për këtë. Paraprakisht ne e diskutuam, por unë ende nuk kam diskutuar me grupin tim në lidhje me komisionin. Ju lutem, bëjeni praktikë të punës që t'u lini pak kohë njerëzve dhe mos lanconi diçka dhe më pas ta minoni vetë procesin, sepse, duke qenë se sapo ma the në këtë sekondë, atëherë unë duhet të jem në gjendje të zgjedh anëtarët, ashtu siç i keni zgjedhur ju, në mënyrë që t'i bëjmë gjërat në mënyrë paralele.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si nënkomision është hera e parë që e dëgjoj sot. Mendoj se në parim nënkomisioni është ide e mirë dhe ne duhet të biem dakord sa duhet të jenë. Kush e mori këtë vendim se sa anëtarë duhet të jenë në këtë komision?! Të shikojmë praktikën se si bëhet, cili është objektivi dhe nesër pasnesër të procedojmë. Pra, të mos imponojmë njëri-tjetrin me vendime,

të cilat më pas vetëm e minojnë procesin, nuk sjellin asnjë lloj rezultati, ta bëjmë praktikë të punës, në mënyrë që të kemi konsensusin dhe respektin e njëri-tjetrit.

Në lidhje me takimin e sotëm, patjetër rekomandimet e OSBE-ODIHR-it janë një nga pikat që kemi objektiv të axhendës së kësaj reformë, por nuk është pika e vetme që do të diskutojmë, mund të jenë edhe gjëra të tjera.

Sot kemi pasur disa takime dhe për rekomandimet e OSBE-ODIHR-it. Pak a shumë kemi rënë dakord. Ne do të shikojmë dy draftet, të cilat na janë dhënë në tetor dhe në dhjetor. Më pas është në dorën e opozitës që t'i shqyrtoi dhe t'i shkojë, pra të kemi pak kohë për t'i shqyrtuar këto dy drafte: Nëse ne do të mbajmë njërin nga këto dy drafte, apo duam ta ndryshojmë dhe të shtojmë disa gjëra shtesë. Një gjë që është shumë e qartë nga opozita dhe kolegët e mi janë të hapur të flasin vetë në lidhje me këtë gjë: në asnjë lloj mënyrë nuk do të pranojmë një proces me dy faza. Këtë gjë nuk do ta marrim fare përsipër. Detyra jonë është që ne të vijmë me një lloj propozimi konkret, të kemi një vendim qartazi se cili është sistemi që ne do të shtyjmë përpara. Pra, të mos thotë zoti Roshi një gjë tjetër, zoti Alimadhi një gjë tjetër, Rudina një gjë tjetër apo zoti Murrizi një gjë tjetër. Ne të gjithë si opozitë kemi për detyrë të kemi një sistem të qartë dhe detyra jonë, në mënyrë që të ecim në mënyrë paralele me rekomandimet e OSBE-ODIHR-it, është që ta bëjmë brenda dhjetorit. Pra, që të kemi një propozim konkret në llojin e sistemit që ne duam, ta mbështesim dhe ta miratojmë, prandaj inkurajoj kolegët e opozitës që ta shqyrtojmë këtë vendim midis nesh, pas mbledhjes së sotme.

Ne kemi pasur edhe një propozim apo një depozitim nga shoqëria civile për ndryshimet apo për rekomandimet, që janë bërë prej tyre (prej katër shoqërive civile). Është një iniciativë goxha e madhe dhe rekomandimet e tyre patjetër do t'i marrim parasysh, sepse ata luajnë në rol të veçantë. Të gjitha këto propozime janë në tryezën tuaj.

Ndër to thuhet, jo vetëm për financimin e partive politike, por flitet edhe për ndryshimin e sistemit.

Besoj se kjo do të jetë një bazë e shëndoshë për ne, që ta shikojmë me vëmendje dhe të krijojmë idenë e qartë se çfarë sistemi zgjedhor do të propozojmë konkretisht.

Për sa u përket rekomandimeve, siç e thashë, keni dy drafte, draftin e tetorit dhe draftin e dhjetorit.

Duhet që ne t'i shikojmë të dy këto drafte, të shohim cilin draft do të mbajmë ose nuk do mbajmë asnjërin dhe do të kemi draftin tonë. Kjo është në dorën tonë, por duhet të kuptojmë, nga ana tjetër, se edhe punën që është bërë nuk duhet ta zhbëjmë, pra duhet të

vlerësojmë edhe punën e bërë, por duke e parë me këndvështrimin tonë dhe ashtu siç mendojmë ne se është më e drejtë.

Janë shumë rekomandime, po të marrësh katër zgjedhjet e fundit, janë mbi 70 rekomandime të OSBE-ODIH-it, kështu që është në dorën tonë se si do ta vëmë theksin.

Unë e di shumë mirë, kur kemi diskutuar me kolegët e opozitës depolitizimin e administratës, nuk kemi diskutuar për një depolitizim të pjesshëm. Kemi pasur mendime të ndryshme për këtë gjë.

Të gjitha këto gjëra që sapo përmenda ne do t'i shqyrtojmë me kujdes dhe do të kemi një takim tjetër për rekomandimet, por theksoj se ne nuk pranojmë të kemi një reformë në dy faza.

Faleminderit!

Damian Gjikhuri – Urdhëroni, zoti Murrizi!

Muslim Murrizi – Edhe unë mbështes absolutisht atë që tha zonja Hajdari. Të njëjtën gjë ia thamë para gjysmë ore Boshartit dhe Sorekës, që ne nuk votojmë në dy, tre apo në gjashtë faza. Reforma zgjedhore nuk është garë 4x4, që të bëhet me stafeta. Që të jemi më konkretë ata mund të kenë detaje teknike apo jo në draftin që mund të na e keni vënë në dispozicion, se shoh disa nene të ndryshuara aty. Ky komision duhet të përqendrohet në katër pika kryesore, pastaj mund ta ndani në nënparagrafë si të doni, siç ka ndarë Gjermania dy pika në nëntë paragrafë.

Së pari është sistemi zgjedhor.

Së dyti është depolitizimi i komisioneve.

Së treti është financimi i partisë.

Së katërti është vota e emigrantëve.

Ky është thelbi që unë kam pranuar të jem anëtar i këtij komisioni. Sa për buzëkuqe e të tjera nuk jam. Ai nuk sheh nga sytë, ju thoni më duket se e ka fajin qerpiku. Ai është qorruar. Kështu që unë nuk merrem me qerpikë, po nuk i erdhi drita. Besoj se edhe kolegët e mi të opozitës janë të një mendimi me mua.

Ju me atë “kçk”-në, po gjetët lekë për të blerë vota, për t'i bërë 84, rrugë e mbarë ju qoftë, se shpejt keni për t'ia parë hajrin!

Unë mendoj se problemet kryesore janë: sistemi zgjedhor, depolitizimi i komisioneve, financimi i partisë dhe vota e emigrantëve. Për të tjerat nuk kam asnjë vërejtje.

Damian Gjikhuri – Unë e sqarova në fillim, që ka një proces politik, që në fund të fundit, ky është komision me natyrë politike, ku ju keni të drejta të barabarta. Çfarë do të

thotë kjo? Do të thotë se nuk na pengon asgjë, që të ecim me këto paketa në komision, paralel. Pastaj, është vendimmarrja juaj. Unë nuk ju imponoj dot. Për mendimin tim, kur komisioni është themeluar në fillim, ka qenë adresimi i rekomandimeve të OSBE/ODIHR. Hajde ta heqim këtë në parim njëherë, këtu brenda. Pra, të biem dakord me këtë zgjidhje, për sa i përket administratës zgjedhore dhe asaj që ju e keni merak, çështjes së barazisë gjinore apo elementë të tjerë, të cilët janë në rekomandim, sepse, nuk mund të themi se një rekomandim është më pak i rëndësishëm se tjetri. Rekomandimet janë aty për t'u zbatuar.

Edhe unë këtë propozova: që paketat të vijnë e të diskutohen edhe më gjerë. Unë nuk thashë se paketa do të shkojë në parlament e të votohet. Ajo do të shkojë një e tërë, sepse reforma është një. Propozimi juaj është që të ndahet në dy faza. Për momentin ju nuk jeni dakord. E lëmë këtë dhe vazhdojmë me paketën e ODIHR-it, që e kemi në objektin si Komision i Reformës Zgjedhore. Në lidhje me çështjen e sistemit, jua kam dhënë iniciativën totalisht si opozitë. Prandaj i thashë edhe Rudinës: ejani me propozim, dhe ta diskutojmë, të hapet edhe ai debat, por ne nuk kemi pse të pengohemi.

Unë them se sot mund të marrim këtë vendim: që ekspertët, për çështje shumë më pak të debatueshme... Le t'i heqim gjërat që janë më pak të debatueshme. Kemi debate në lidhje me financimin e zgjedhjeve? Mund të kemi debate të natyrës teknike. Shumë mirë, le t'i sjellin propozimet, t'i diskutojmë, t'i miratojmë. I kemi aty. Kemi debate për çështjen e barazisë gjinore? Mund të kemi. Unë them se s'kemi shumë. Edhe aty mund të biem dakord.

Pra, ne mund të fillojmë të heqim një pjesë të mirë të rekomandimeve. Administrimin zgjedhor dhe procesin e ankimit, i lëmë për në fund. Për mendimin tim, patjetër që sistemi dhe vota e emigrantëve janë gjëra që duan një çikë më shumë kohë. Vota e emigrantëve mund të dojë edhe më shumë kohë, sepse është edhe proces i komplikuar logjistik, sa i takon mënyrës se si do të funksionojë. Është edhe në funksion të sistemit zgjedhor. Pa e ditur qartë se çfarë sistemi zgjedhor do të kemi, nuk e realizojmë dot votën e emigrantëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, me radhë. Unë po them: ejani me propozim në lidhje me sistemin zgjedhor. Ju do të vini me një propozim, ramë dakord. E dyta, të ecim me paketën e rekomandimeve të ODIHR-it. T'i themi javës tjetër, për çfarë janë gati ekspertët? Tri-katër çështje. T'i miratojmë, të hapim edhe diskutimin publik. se ky komision nuk është që të mbyllemi në një ditë dhe t'i kalojmë të gjitha. Për këtë po them. Në lidhje me komisionin, merrni kohë, siç tha Rudina. Caktoni dy anëtarë për pjesën e financimit të partive politike. Nuk është se do ta

marrim vendimin sot. E mira është t'ia komunikojmë njëri-tjetrit. E rëndësishme është që komisioni të fillojë punën.

Unë them të ecim me këtë, të mos e mbajmë peng si proces vetëm e vetëm që, po nuk u bë kjo nuk do të ecë asgjë tjetër. Në fund të fundit pastaj, në qoftë se vendosni ju politikisht, që do ta mbani peng, kjo është zgjedhja juaj, është një proces që ju e vlerësoni vetë, nëse do të fitoni politikisht apo do të humbni më shumë. Kjo është çështja juaj. Unë nuk jam këtu për t'ju dhënë mendim, që po bëni zgjedhjen e duhur.

Kësisoj, mendoj të ecim në këtë proces, e pastaj këtu jemi, po disa gjëra që i kemi gati, një punë e mirë që është bërë me ekspertizë perëndimore, le të vijmë në komision e të diskutohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, e the, e the atë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

O Myslim, të thashë pra. Unë mendoj t'i miratojmë këtu. Ka dy miratime, ka dy votime: votimi këtu, mes nesh, dhe votimi në parlament. Votimi mes nesh nuk na pengon të themi se paketa është gati.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po nuk e ke sistemin fare. Sistemi është ndryshim në Kushtetutë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, të lutem tashti!

Rekomandimet e ODIHR-it duhet të ecin, t'i kemi ne këtu.

Myslim Murrizi – Po pse? Nuk i dua fare, nuk i dua ato, nuk i votoj.

Damian Gjikhuri – Mirë pra, dakord, Myslim, e the qëndrimin tënd!

Myslim Murrizi – Ta thashë, por po ta them prapë.

Damian Gjikhuri – Po, Blerina.

Blerina Gjylameti – Në radhë të parë, unë besoj se nuk duhet të mbytemi në një pikë ujë. Për sa kohë është bërë një punë e mirë, sikundër edhe dy bashkëkryetarët e kanë thënë në adresimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, të cilat janë në draft apo mund të vijmë në drafte më të përditësuara, pse duhet ta pengojmë punën tonë? Që në krye të herës është diskutuar, madje edhe mbas tavolinës së organizuar nga OSBE/ODIHR, që ju duhej të vinit me një propozim në lidhje me ndryshimin e sistemit. Atëherë, është në të drejtën tuaj të vini me një propozim konkret. Nuk duhet të humbasim kohën e vyer, duke vazhduar të themi se duhet të ndryshojmë sistemin. Jemi dakord! Sillni propozime dhe diskutojmë se cili sistem

është i gjithëpranuar. Të gjithë kemi eksperiencë, sepse jemi prej vitesh në politikë, disa janë edhe të rinj, por të gjithë e kuptojnë se nuk ka reformë zgjedhore, e cila kalon me ndryshime, pa qenë e gjithëpranuar. Ne jemi të hapur, hajdeni me një propozim konkret dhe ta diskutojmë, ndërkohë ne mund ta vijojmë punën në komision për të gjitha çështjet që nuk kemi diskutime me njëri-tjetrin. Unë besoj se kemi kundërshti në depolitizimin e komisioneve. Jo! Unë nuk besoj se nuk ka kundërshti për të parë se si duhet të përmirësojmë të gjithë procesin zgjedhor. Prandaj, hajdeni ta kalojmë këtë pjesë.

Sa i takon pjesës së barazisë gjinore, edhe këtu nuk besoj të kemi ndonjë gjë, sepse ndryshime të tilla ne i pranojmë, prandaj të vazhdojmë me këtë pjesë, pse duhet ta pengojmë dhe të vazhdojmë të bëjmë nesër një reformë, e cila nuk mund të zbatohet, për shkak se na ka munguar vullneti për të ecur përpara. Në këtë aspekt, për pjesën e parë, që nuk kemi kundërshti, të vazhdojmë më tej, ndërsa sa i takon pjesës së dytë, për të cilën ka diskutime, sepse sa i takon ligjit të financimit të partive politike, të dyja palët këtu apo edhe më gjerë ka hapësirë për shumë diskutime, kështu që le të marrë më shumë kohë.

Ne duhet të ulemi. Ndërkohë mendoj se nuk duhet të ngremë një nënkomision, por një grup pune për të vazhduar me këtë pjesë, pasi ngritja e një nënkomisioni nuk na lejohet edhe nga ana e Rregullores. Kjo do të thotë që nuk jemi të mandatuar dhe të kemi një pozicion ndryshe nga të tjerët, por jemi thjesht një grup pune që është më i fokusuar në këtë pjesë.

Nga ana tjetër, nëse vazhdojmë të diskutojmë se pa u ndryshuar sistemi nuk do të votojmë, po ju them se vota këtu nuk është një votë definitive dhe nuk sjell asnjë lloj ndryshimi, por është një votë që tregon vullnetin e mirë që kanë të dyja palët për ta realizuar këtë reformë.

Më pas kur të arrijmë në çështjet e sistemit, te vota e emigrantëve, apo edhe më tutje me ligjin e financimit, i cili është një problem relativisht i madh, besoj se çfarëdolloj sistemi të ngremë po qe se pyesim kolegët secili prej tyre ka mendime të ndryshme.

Ne e pamë edhe në tryezën tjetër që u organizua se parti të ndryshme kishin mendime të ndryshme, por edhe midis nesh, ndonëse më pak, kemi mendime të ndryshme, kështu që për këtë pjesë diskutimi për sistemin kërkon më shumë kohë. Le të vazhdojmë më tej, hajdeni me një propozim të hapur, të diskutojmë së bashku dhe në fund të ditës unë dhe kolegët e mi jemi për të gjetur një zgjidhje edhe për sistemin, por në radhë të parë duhet ta kuptoni ju si palë përballë se kë sistemi kërkon të propozoni. Nëse ju vini pa ndonjë propozim, atëherë kjo është një çështje që tregon se ju mungon vullneti për të qenë këtu. Unë kështu e mendoj.

Sa i takon pjesës për jo apo për po, është një çështje që ne e mendojmë në këtë mënyrë, por kur të merrni fjalën më pas mund të kundërshtoni.

(Diskutime pa mikrofon)

Atëherë, ta tregojmë me veprime konkrete. Unë mendoj që...

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Murrizi, vullneti tregohet me veprime konkrete, nuk tregohet vetëm...

(Diskutime pa mikrofon)

Prandaj besoj dhe unë. Hajdeni ta tregojmë me veprime konkrete dhe jo të vijmë këtu e të vazhdojmë t'i humbasim kohë njëri-tjetrit dhe të mos i japim zgjidhje. Në këtë pikë propozoj të vazhdojmë pjesë-pjesë, ndërkohë vazhdojmë edhe me sistemin, sepse jam e bindur që edhe pjesa që kemi përballë, duan të diskutojnë edhe për sistemin dhe gjetjen që ky sistem të jetë i mirëpranuar nga të gjithë.

Faleminderit!

Damian Gjinkuri – Zoti Gjoni, e ka fjalën.

Ralf Gjoni – Faleminderit!

Zonja Gjylameti, ne duhet të ndajmë mendjen dhe të flasim bashkërisht jashtë medieeve, sinqerisht si kolegë, sepse kam bindjen e plotë që nëse gjejmë vullnet të sinqertë mund të arrijmë një produkt shumë cilësor dhe shumë pozitiv për shqiptarët. E kuptoj, ndoshta disave prej jush termi “për shqiptarët” mund t'i tingëllojë pak cinike, por realisht besoj se ne sot kemi përgjegjësi për njerëzit, sepse jemi në një moment kyç, hapen apo nuk hapen negociatat, pasi ende nuk jemi të sigurt se çfarë do të ndodhë në datën 15.

Sa i përket eksperiencës dhe memories politike disa prej nesh i kanë të gjata, ashtu edhe sa i takon funksionimit të brendshëm të partive politike, qoftë PS, PD apo LSI, sidomos ne që kemi qenë në koalicion me këto dy parti e dimë mirë edhe vullnetin, edhe mungesën e vullnetit. Gjithashtu, e dimë mirë edhe në memorien politike që ju si parti, por edhe PD-ja, le të flasim hapur dhe pa akuza, me sinqeritet, jeni mjeshtra të qepjes dhe të kopsitjes së gjërave.

Po i marr gjërat një nga një. Këtë punën e sistemit nuk e shoh thjesht si ndryshim kushtetues për të ndryshuar sistemin zgjedhor, pra proporcional-rajonal, proporcional-kombëtar, lista të hapura apo të mbyllura. Kur flasim për sistem, sepse kam përshtypjen që ka një keqkuptim të terminologjisë së sistemit, unë në botëkuptimin tim politik e kuptoj si sistemi i drejtësisë edhe sistemi zgjedhor, por sistemi përfshin disa hallka: si, Kodi Zgjedhor, ligjin për partitë politike, ndryshimet kushtetuese, listat për financimin e partive.

Unë besoj se ne kemi detyrim si komision, madje e kemi edhe në objektin e punës të trajtojmë reformimin e sistemit zgjedhor jo vetëm ndryshimet kushtetuese, sepse unë reformim të sistemit nënkuptoj edhe rekomandimet e OSBE-ODIHR-it.

Të ndalemi te rekomandimet e OSBE-ODIHR-it. Është e vërtetë ajo që thatë ju se është bërë një punë, e mirë, e keqe nuk ka rëndësi, por është bërë punë. Nuk ka qenë përgjegjësia jonë që këto rekomandime kanë dy vjet që nuk janë adresuar. Duhet t'i vëmë pikat mbi i. Nuk ka qenë bllokimi ynë arsye për mosadresimin e këtyre rekomandimeve.

Ju folët për rolin tonë bllokues në komision. Ne nuk jemi aspak bllokues. Zonja Gjylameti, prania jonë në komision...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Damian Gjijknuri- Më falni, ju lutem, kjo tavolinë del jashtë kontrollit po u morëm me njëri- tjetrin.

Ralf Gjoni – Ju lutem, a do të më lini të mbaroj? Ju lutem, unë nuk ju lejoj ju të më bllokoni fjalën! Unë ju dëgjova me kujdes, ju lutem, mos na bëni zhurmuesin si në media.

Nuk është normale të flasësh ti kur unë flas. Nuk është etike, zoti Fino. Nuk keni respekt për opozitën.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Të nderuar kolegë, iu drejtova zonjës Gjylameti meqë na u drejtua neve, si anëtarë komisioni. I referohem në mënyrë specifike asaj që ju thatë kur iu referuat pjesës sonë.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, a ka mundësi ta mbaroj fjalën!

T'i marrim çështjet një nga një. Sistemi zgjedhor përfshin Kodin Zgjedhor, ku pjesa tërësore e amendimeve bazohet në rekomandimet e OSBE-ODIHR-it. Në dijeninë time, jo të gjitha rekomandimet janë adresuar në të dy draftet e tetorit dhe të dhjetorit. Unë mendoj se për sa u përket rekomandimeve ne kemi nevojë, si grup i opozitës, t'i shohim nga fillimi rekomandimet dhe të shohim si do të aplikohen në një draft të tretë të dakordësuar mes nesh, sepse nuk është përgjegjësia dhe detyra jonë t'i marrim të mirëqena draftet e lëna në tavolinë nga pala që doli ose edhe ju si palë me ta.

Së dyti, sistemi përfshin ligjin për partitë politike. Ne duhet të biem dakord si komision që partitë politike si në të gjitha vendet e Europës ose të BE-së nuk janë pronë private, etnitet privat, as biznes privat. Partitë politike duhen trajtuar përmes këtij ligji si një entitet publik me përgjegjësi publike, siç i ka çdo institucion publik. Kjo do të thotë që ligji

për partitë politike, si pjesë e këtij reformimi të sistemit zgjedhor, ka nevojë të rishikohet, të amendohet në mënyrë radikale për të garantuar: së pari, mënyrën si përzgjidhen kandidatët për deputetë.

Të nderuar deputetë, ne e dimë mirë se në partitë nga vijmë ju dhe ne, të zgjedhësh një sekretar të përgjithshëm, ose sekretar ndërkombëtar brenda partisë, nuk është një lloj si të zgjedhësh një listë me kandidatë për deputetë, që shkojnë në Kuvendin e Shqipërisë dhe kanë përgjegjësi publike dhe juridike brenda Kuvendit të Shqipërisë. Pra, duhet prekur ligji për partitë politike, ku të garantohet edhe financimi, edhe transparencja e financimit të partive politike, kërkesë kjo e partnerëve tanë ndërkombëtarë. Së dyti, rekomandimet e OSBE-ODIHR-it nuk prekin në mënyrë thelbësore depolitizimin e administratës zgjedhore duke filluar që nga KQZ-ja deri te KZAZ-të dhe të gjitha hallkat e administratës zgjedhore, sepse po nuk u depolitizua kjo, ne nuk mund të kemi votë të drejtë dhe të barabartë, sepse ajo votë nuk numërohet në mënyrë të barabartë.

Disa prej kolegëve folën për barazinë gjinore. Për mua personalisht ka më tepër rëndësi barazia e votës e garantuar me ligj dhe në proces, sesa barazia gjinore. Barazia gjinore duhet parë patjetër, sepse ndryshimi i sistemi në Kushtetutë mund ta prekë edhe atë.

Së treti, prekim edhe sistemin për sa u përket ndryshimeve kushtetuese. Jam dakord edhe me ju që na takon të sjellim propozimet tona konkrete, se pa ato, kjo punë nuk mund të bëhet, dhe ne do t'i sjellim propozimet, por ka një shqetësim, insistimi juaj për ta ndarë reformën në dy faza, për mua është indikator i mungesës së sinqeritetit për sa i përket vullnetit tuaj për të prekur hallkat e tjera të sistemit me miratimin e OSBE-ODIHR-it; çdo lloj alibie që duhet të ndërtojmë brenda dhjetorit me OSBE-ODIHR-in dhe pastaj të kalojmë në një fazë të dytë "Ejani të flasim, se do të biem dakord", për ne duhet të jetë e papranueshme.

Unë bashkohem me zotin Murrizi, në qoftë se ju doni ta bëni me 84 vota në parlament, duke anashkaluar këtë komision, bëjeni, nuk ka asnjë lloj problemi, ne jemi në këtë pozicion të bashkuar dhe të vendosur që ta trajtojmë reformimin e sistemit zgjedhor si një paketë tërësore ku preken të gjitha hallkat paralele. Unë kështu e shoh personalisht.

Faleminderit!

Damian Gjikhuri – Për të kanalizuar bisedën, por të mos dalim jashtë teme, do t'ju kërkoja miqësisht që të evitohet citimet e njëri-tjetrit apo insinuatat në lidhje me emocionet e dikujt, apo vlerësimet politike që mund të keni përtej kësaj tavoline.

Që në fillim e shtrova bisedën kështu: ju keni të gjithë të drejtën politike për ta bllokuar, penguar dhe për të mos dhënë votat. Është një instrument juaji, sepse, në fund të fundit, i keni ato vota që jeni aty, se ndaj është krijuar ky komision i reformës zgjedhore.

E dyta, thashë që në fillim që keni të drejtën e propozimit dhe ju takon ju si iniciativë për të ardhur me ide për sistemin, dhe i qëndroj kësaj. Kjo do të thotë se është pjesë e diskutimeve të kësaj tavoline.

E treta, për ta kanalizuar punën, sepse ne duhet të ecim paralel, nuk na pengon asgjë, për hir të publikut dhe të gjithë partnerëve europianë që presin që ne t'i adresojmë ato rekomandime, që të mos i diskutojmë me njëri-tjetrin si komision. T'i diskutojmë bazuar në një draft, që nuk do të vijë kallëp, meqenëse kanë rënë dakord të tjerët, dhe ju s'keni qenë e ne duhet ta marrim të mirëqenë, përkundrazi, ai është një draft pune dhe do të thotë se ne do ta diskutojmë këtu, do ta diskutojmë edhe më gjerë dhe do të biem dakord nëse do ta pranojmë këtë variant të administrimit zgjedhor, apo do të pranojmë këtë rekomandim. Do të thotë se ne do të biem dakord për ato në mënyrë vullnetare bashkërisht. Në fund, e keni ju në dorë të thoni nëse jeni gati për ta çuar, apo nëse jeni gati për ta ndarë në dy faza, por unë mendoj që duhet ndarë. Dakord, është e drejta juaj, nuk do të debatojmë për këtë, por ama ne duhet të ecim paralel me punën. Unë nuk thashë që të ndajmë fazat sot, por t'u vëmë një detyrë ekspertëve, që javës tjetër të na sjellin çfarë kanë më të thjeshtë dhe që është më pak e debatueshëm. Unë zgjodha temat më të thjeshta, në mënyrë që ato më problematiket t'i adresojmë në fund, që varen edhe nga propozimi që do të vijë për sistemin, kurse këto çështje që janë më të thjeshta dhe që është bërë një punë e mirë deri tani për to, le të vijnë këtu dhe t'i diskutojmë.

Për sa i përket ligjit të partive politike, ai grup pune që mund të ngrihet, unë thashë nënkomision a grup pune, e rëndësishme është që nuk është pjesë e lidhur me patjetër që duhet të jetë brenda dhjetorit dhe duhet të kalojë; i është lënë një detyrë Shqipërisë, ne e morëm përsipër si komision, se mund të mos ishte fare detyra jonë, por mund ta zgjidhte Komisioni i Ligjeve, të ngrinte një grup pune, t'i shkante parlamentit me ligjin për partitë politike dhe ndryshonte financimi. Kështu që ajo nuk ka pse të lidhet domosdoshmërisht me të, nuk them se po qe gati dhe është bërë një punë e mirë, edhe atë ta çojmë së bashku me paketën e reformës zgjedhore, por mos i lidhni këto gjëra, sepse, në fund të fundit, ne e morëm përsipër atë meqenëse ishte një komision i ngritur, por nuk është domosdoshmërisht gjëja që kemi parësore. Komisioni është ngritur për këto çështje: rekomandimet e ODHIR-it – sistem zgjedhor; vota e emigrantëve është një gjë që do ta lëmë për fazën e dytë dhe duhet ta

lëmë se do shumë kohë. Ka shumë probleme dhe ne nuk jemi ende gati. Thashë, ju e keni sërish në dorë të thoni se nuk jemi ne, pavarësisht se Shqipëria ka prioritete të tjera dhe kombi mund të ketë interes tjetër, në fund të fundit, ne jemi aktorë politikë, do të vëmë veton këtu, e pranojmë se do ta marrim këtë kosto. Kjo është puna juaj, këtë do ta gjykojë publiku. Unë nuk jam këtu..., mbase ju e keni mirë dhe unë gabim, por është koha ajo që do t'i tregojë disa gjëra. Ju erdhi rasti ta keni këtë votë, shfrytëzoheni, por, njëkohësisht, të krijojmë mundësitë për të ecur përpara, ndryshe, do t'u japim të drejtë atyre që janë në rrugë, të cilët thonë se me atë lloj parlamenti nuk ecet dot përpara dhe ne jemi aktorët e vërtetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë do t'i thërras, sepse është vendim i komision, pavarësisht se ata nuk vijnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Megjithatë, miqësisht, unë mendoj që ne të marrim në ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aman, se po bëjmë muhabete kafenesh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, me radhë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, e ka Bashkimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Bëri koment, nuk është se ...

Damian Gjijnuri – Bashkim, kërkoj të qëndrojmë brenda temës.

Bashkim Fino – Do të jem konkretë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kam marrë unë fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian Gjijnuri – Adriatik, ta dëgjojmë edhe atë dhe pastaj ...

Bashkim Fino – Ralf, a mund të flasë unë? Pas teje e kam unë gjithmonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zgjidhje do të jap edhe unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kam kërkuar fjalën. Zonja Hajdari tha që do të flasim një anëtar andej, një anëtar këtej.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Foli Ralfi, tani më lejo të flas edhe unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë procedure? E shpjeguan dy herë dhe ne nuk biem dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk do të bëjmë si kalamajtë. Më lejo të flasë. Nëse do të bësh muhabet me mua, hajde e bëjmë jashtë në kafe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zotërinj bashkëkryetarë, ajo që unë dua të them ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos u mërzit! Pse mërzitësh?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë jam njëlloj si ju. Më dha fjalën. Çfarë të bëj, ta mbyll fjalën?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian Gjikhuri – Fjalën e ka Bashkimi, pastaj Adriatiku.

Bashkim Fino – Zotërinj bashkëkryetarë, ajo që dua t’ju them për të ndihmuar, është se ne e kemi filluar mbledhjen në orën 10:00 dhe deri tani nuk kemi bërë asgjë. Pse bëjmë retorikë politike? I kërkojmë falje zotit Ralf që i ndërhyrë, por nuk mundet dot që çfarë tha zoti Murrizi (më falni, zoti Murrizi), unë t’i mbaj shënim dhe të filloj të bëj diskutimin tim në funksion të diskutimit të Murrizit. Jo, ne këtu do të diskutojmë si anëtarë të komisionit.

Zoti Murrizi tha që janë katër çështje kryesore, kurse unë mendoj se janë tri: çështja kryesore është sistemi zgjedhor, që e keni kërkuar ju, kurse ne nuk e kemi në plan; çështja e votës së emigrantëve, që e kemi kërkuar ne, kurse ju nuk e kishit në plan; rekomandimet në tërësi të OSBE-ODIHR-it, që i kemi përpara. Këto janë tri çështjet për të cilat ne do të diskutojmë në këtë komision. Meqenëse jam deputet i vjetër dhe kam qenë anëtar në disa komisione (kam këtu Ilir Rusmalin, që ka qenë edhe ai) ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, e kam në kuptimin që ka qenë kryetar i respektuar i Komisionit të Ligjeve dhe e respektoj.

Unë dhe zoti Murrizi jemi deputetë të vjetër këtu, pa dashur të ofendoj asnjërin këtu. Kur një projektligj vjen në komision, përcaktohet relatori nga të dy krahët, përgatitet një draft dhe më pas diskutohet.

Konkretisht, ne kemi disa vërejtje nga *OSBE-ODIHR*-i. Ne kemi ekspertët tanë, ju keni ekspertët tuaj, janë tri çështje për t'u diskutuar. A do të fillojmë t'u japim material ekspertëve për të diskutuar dhe për të na sjellë një draft, që ne më pas të diskutojmë këtu në komision për nene konkretë, duke filluar nga sistemi zgjedhor, siç thoni ju, nga rekomandimet e *OSBE-ODIHR*-it e deri te vota e emigrantëve. Është një çështje që do të jetë me ...

Bashkëkryetari ynë dha një propozim. Nuk ka asgjë të keqe nëse në fillim ne diskutojmë rekomandimet e *OSBE-ODIHR*-it, sepse edhe nëse ne i diskutojmë dhe i miratojmë bashkarisht, është një punë e cinguar, për aq kohë sa ne nuk e kemi mbaruar të gjithë draftin, që t'ia paraqesim parlamentit dhe të votojmë në unanimitet të plotë. Pra, nuk zgjidhet problemi më mbarimin e diskutimeve për rekomandimet e *OSBE-ODIHR*-it, ramë dakord me ju me hile (më lejoni t'ju drejtohem kështu), nuk diskutojmë as për sistemin dhe as për votën e emigrantëve, dhe në seancë plenare miratojmë ato për të cilat ramë dakord. Jo, sepse para se të shkoj në seancë plenare, do të bëhet një raport përfundimtar i komisionit, i cili nuk mund të quhet raport përfundimtar vetëm me një pjesë të atyre që ne do të biem dakord.

Pra, që ne të hapim dritën jeshile, të punojmë, të mos bëjmë retorikë politike dhe të mos debatojmë me njëri-tjetrin se si foli Gjylameti dhe si foli Ralfi, unë mendoj që me ekspertët që kemi, nënkomisionet, që janë shumë të rëndësishme, sepse na involvojnë edhe ne, deputetët, për të interesuar, mund të ngremë dy-tre grupe për të punuar në tri sektorë të ndryshëm.

Një grup, tha bashkëkryetari ynë, mund të punojë për financimin e partive politike dhe për vërejtjet e *OSBE*-së në tërësi, një grup tjetër me dy anëtarë nga ne dhe dy nga ju mund të punojë për sistemin. Pra, ulemi edhe me ekspertët, por edhe ne dy e nga dy punojmë dhe sjellim disa variante këtu. Ju mund të keni një variant, por mund të kem edhe unë tri variante. Do t'i diskutojmë dhe në fund do të gjejmë të përbashkëtat, nëse do të mundet. Një grup mund të diskutojë për votën e emigrantëve. Në momentin që e bëjmë kështu, u vijmë në ndihmë ekspertëve, por edhe ne involvohemi, interesohemi, punojmë gjatë kësaj kohe dhe nuk vijmë në mbledhjen e këtij komisioni kur të na njoftojnë Rudina dhe Damiani, por jemi

të gatshëm gjatë gjithë javës të punojmë me grupin e ekspertëve sipas ndarjes konkrete. Unë mendoj se kjo është gjë e mirë.

Merreni kohën e nevojshme dhe bëjeni këtë ndarje. Vendosni dy deputetë që të punojnë me rekomandimet e OSBE-së, dy deputetë të tjerë të punojnë për sistemin zgjedhor, dy të tjerë të punojnë për votën e emigrantëve dhe, bashkë me ekspertët e të dyja palëve, të bëjmë nga një draft që ta paraqesim këtu. Na lini kohë për draftin që paraqesin ata; nëse është i përbashkët nuk ka asnjë problem, por nëse ka një apo dy variante, natyrisht të dyja palëve na duhet kohë për ta konsultuar, dhe më pas të vijmë me një diskutim konkret në komision për të marrë disa vendime konkrete.

Mos krijoni asnjëherë alibinë që ne nuk kemi dëshirë për ta bërë këtë gjë. Ju jeni kolegët tanë të opozitës, ne i respektojmë edhe ata që janë jashtë dhe duam ta bëjmë Kodin Zgjedhor sa më të mirë që të jemi të gjithë bashkarisht. Jua kam thënë edhe në mbledhjen e parë, por po jua them edhe sot, nëse ju vendosni veton të mos votoni, nuk shkon dot një material në parlament për t'u votuar, nëse ne vendosim veton për një nen të caktuar, nuk shkon dot materiali në Kuvend për t'u votuar, sepse Kodi Zgjedhor votohet me konsensus.

Historikisht, në 22 vjet në parlament, e kemi votuar me konsensus. Nëse duam të bëjmë gjë të mirë, unë jam dakord me atë që tha Damiani dhe që Rudina e pranoi, duhet të ngremë këto tri grupe. Dy nga ne u caktuan për t'u marrë me rekomandimet e OSBE-së dhe financimin e partive politike, kështu që mblidhuni edhe ju dhe vendosni dy prej jush; vendosim dy nga ju dhe dy nga ne për sistemin zgjedhor dhe bashkë me ekspertët sjellim një material këtu.

Ne dalim në televizione dhe flasim për sisteme të ndryshme, por duhet të japim argumente pse duhet të jetë iks sistem. Po i drejtohem Ralfit, pa të keq: pse duhet të jetë sistemi që thua ti? Ma argumento pse i duhet Shqipërisë ai sistem. Nga ana tjetër unë do të jap mendimin për një sistem tjetër, por duhet të jap edhe unë argumente. Në këtë formë bëhet një debat profesional, duke na ndihmuar ekspertët, të cilët i kemi shumë të mirë, për të vendosur, në fund të fundit, se si do ta bëjmë sistemin apo si do ta bëjmë financimin e partive.

Ka dy elemente shumë të rëndësishme për partinë, sepse atje fillon demokracia. Është tjetër gjë financimi i partive, që e ka Kodi Zgjedhor dhe është tjetër gjë ligji për partitë politike. Ligji për partitë politike, për mendimin tim, duhet riparë, por është diçka që nuk na takon neve si komision i reformës zgjedhore, por parlamentit, Komisionit të Ligjeve si komision përgjegjës, ku jeni edhe ju prezentë, nëse ne duam të bëjmë ndryshime për ligjin e

partive. Nëse bëjmë ndryshime për ligjin e partive politike, mbase mund të ndikojnë pozitivisht edhe në reformën e re zgjedhore.

Financimi është tjetër gjë, kurse ligji i partive është më vete. E thashë këtë jo për treguar që jam më i zoti dhe më i zgjuar nga ju, por që duhet të bëjmë një ndarje dhe duhet t'i lëmë mundësi edhe ekspertëve, sidomos ekspertëve të OSBE-ODIHR-it, edhe në grupe pune të vogla për të paraqitur këtu tri drafte: një draft për sistemin zgjedhor, një draft për rekomandimet e OSBE-ODIHR-it dhe një draft për votën e emigrantëve. Këto janë tri çështjet kryesore, edhe pse mund të ketë edhe gjëra të tjera. Duhet ta bëjmë efektive mbledhjen e komisionit dhe të mos bëjmë retorikë politike. Ti dëgjove zonjën Gjylameti (u nxehe dhe unë të kërkoj ndjesë që ju ndërhyra) dhe më pas thatë, zonja Gjylameti tha këtë, këtë ... Me njëri tjetrin do të merremi ne? I bie që edhe unë të merrem me Myslimin për ato që tha, por edhe me ty për çfarë the. Jo, unë kam ardhur këtu të jap ndihmën time si pjesë e formacionit tim politik për të rregulluar sistemin zgjedhor.

E fundit (ta thënë shumë dashamirësisht ty, por edhe deputetëve të opozitës), ju keni një problem tuajin, personal, që duhet ta zgjidhni ju personalisht. Nëse nuk e zgjidhni ju, nuk jua zgjidh dot unë, as PD-ja jashtë, as LSI-ja jashtë. Ju duhet të zgjidhni vetë se cili është koncepti juaj politik i së ardhmes. Ju thoni, për shembull, që duam të bëjmë sistemin zgjedhor proporcional në rang Shqipërie. Dakord, le ta bëjmë, por pse duhet të të dëgjoj ty për këtë sistem zgjedhor, kur nuk të kam element dhe faktor kryesor determinant pas vitit 2021? Flas për këtë pozicion që je sot, sepse nesër mund të jesh ... Të më falësh!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë e kam shumë dashamirëse dhe Ralfi e di këtë gjë. Përderisa unë kam pranuar të ulem në tavolinë në një komision të tillë, do të thotë që do të punoj për të zgjedhur sistemin zgjedhor. Unë e kam dashamirëse këtë. Nuk mundem dot të marr draftin tuaj dhe të ngre dorën. Për mua si Parti Socialiste politikisht nuk ka problem asnjëlloj sistemi. Unë flas si një socialist i vjetër. Unë si socialist ta jap dakordësinë që tani, edhe pse nuk ka ndonjë vlerë, sepse ka nivele politike për të marrë vendimmarrjen. Për mua sistemi nuk ka asnjë problem, sepse unë e kam provuar edhe maxhoritar të pastër, edhe rajonal, kurse kjo në rang Shqipërie është më e thjeshtë akoma, mjafton të ngrihet pragu i partive politike, siç e ka Kosova, në 5% dhe do të ngelen shumë parti të vogla jashtë. Unë nuk e kam fare problem.

Doni me lista të hapura? Personalisht unë nuk e kam fare problem, sepse jam Bashkim Fino dhe kam një jetë në politikë dhe di ta bëj politikën. Mund ta kesh problem ti, jo

ti personalisht, por një politikan i ri, që nuk i ka mundësitë të bëj një luftë politike midis vedit, siç i thoni ju, sesa vota mund të marrë. Unë nuk e kam problem dhe mund të them që ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më dëgjoni, sepse po ju flas shumë sinqerisht. Nuk e kam fare problem të them që ne si PS i kemi të gjitha opsionet e hapura. Problemi është nëse do të bëjmë një sistem që t'u shërbejmë shqiptarëve, siç thatë ju, por t'u shërbejmë edhe forcave politike, në fund të fundit, që janë brenda apo jashtë sistemit në këto momente. Që t'u shërbejmë atyre, duhet të bëjmë një sistem zgjedhor që të kënaqen të gjithë, sepse nuk mund të bëjmë një sistem zgjedhor që të kënaqen vetëm Ralfi dhe Bashkimi dhe të mos kënaqen disa parti politike, që ne të mos bëjmë sikur nuk ekzistojnë.

Unë bashkohem me mendimin e dy bashkëkryetarëve, që me ekspertët që kemi, të huaj, vendas, por edhe të grupeve politike, të ngremë dy-tre grupe pune.

Ne biseduam në grupin tonë dhe vendosëm paraprakisht që unë dhe Damiani do të merremi me problemin e sistemit. Do t'u japim material më të specializuar kolegëve tanë. Siç e tha Damiani, Klodi dhe Gjylameti do të merren me problemin e financimit të partive politike, me votën e emigrantëve do të merret kolegu që kam në krahë, Alketi. Pra, ne e kemi bërë një ndarje të tillë, kështu që bëjeni edhe ju, dhe bashkë me ekspertët të vijmë në mbledhjet në vazhdim me material konkret për të diskutuar dhe për të punuar.

Damian Gjikhuri – Zoti Alimadhi, ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Myslim Murrizi – Nuk dua bajraktarë në politikë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari – Duhet të mos i bëjmë bisedat personale, por të kalojmë...

Nuk kemi respekt fare për njëri-tjetrin. Baza është komunikimi. Nuk jemi në gjendje të komunikojmë normal. Kur dikush flet, nuk duhet t'i ndërhyjmë, e lëmë ta mbarojë mendimin, pastaj flet një person tjetër.

Zoti Alimadhi, që në fillim ne thamë që do ta marrë fjalën dikush nga opozita dhe pastaj një nga pozita. Nuk ka procedurë këtu. Ju e dini shumë mirë që këtu nuk veprojmë me një rregullore që të ndërhyjmë për procedurë.

Ju lutem, pasi të mbarojë zoti Bashkim Fino, e keni ju fjalën. Kur të mbaroni ju, do ta marrë dikush tjetër. Të mbetemi me propozime dhe gjëra konkrete.

Adriatik Alimadhi - Unë nuk jam mësuar të punoj kështu. Ju keni një eksperiencë që të lodhni, të ngarkoni dhe pastaj të bëjmë një material për ta çuar në seancë plenare.

Zotërinj, jeni bashkëkryetarë. Nga momenti që ne nuk kemi dakordësuar qëndrimin politik, ne vazhdojmë kot. Zonja Hajdari jua bëri të qartë. Para se të vinim këtu kishim një takim me dy ambasadorë, të cilëve besoj se jua bëmë të qartë qëndrimin tonë për vazhdimësinë e procedurave të komisionit. Ata e ndanë në dy mundësi: E para, deri në muajin dhjetor për ndryshimet e OSBE-ODIHR-it dhe e dyta ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse i bini vërdallë, zotërinj? A keni rënë dakord politikisht për ndryshimin e sistemit zgjedhor, që jua tha edhe Rudina Hajdari? Bini dakord dhe pastaj të vijmë ne, sepse ky është qëndrimi ynë. Ne jemi për ndryshimin e sistemit zgjedhor, sepse ju si subjekte politike keni shpikur fenomenin e vjedhjes dhe ne kërkonim të na bëni pis. Ju po thoni që të na sillni ne draftet, po këto draftet këtu kush i ka sjellë, zotërinj? Na sillni draftin se si keni rënë dakord politikisht dhe për procedurë vazhdojmë ne, ju japim mendimet dhe propozimet tona, por ju thoni “Na sillni ju, se nuk merrni vesh”. Çfarë është kjo, mor zotëri? Unë kam diçka shumë të rëndësishme në thelb, ju do të na sorollatni ne, sepse politika nuk ka rënë dakord, prandaj hajde të biem dakord në nivel politik për ndryshime në sistemin zgjedhor dhe komisioni le të vazhdojë punën.

Unë këtë mendim kam për procedurë.

Damian Gjikhuri – Faleminderit!

Dua të kanalizoj bisedën, sepse po flasim shqip dhe nuk po merremi vesh. E thamë që Komisioni i Reformës Zgjedhore një nga çështjet ka atë të sistemit, ne ju dhamë të drejtën e propozimit, sepse ju keni qenë shtytësit më të interesuar për ndryshime në sistemin zgjedhor dhe është krejt normale, duke qenë opozitë e re doni që të ndryshojë ky sistem zgjedhor për të parë mundësitë në të ardhmen për veten tuaj. Kjo është krejt normale dhe racionale në politikë, pavarësisht si do të dalë më vonë, domethënë, duke ju dhënë iniciativën kjo çështje bëhet pjesë e tavolinës kur të vini me një projekt të përputhur me një analizë racionale se përse duhen këto ndryshime nga pikëpamja politike. Pra, kemi rënë dakord dhe nuk ka nevojë të thoni doni nuk doni. Kur e kemi ngritur këtë komision e kemi shënuar atë si çështje.

E dyta, u tha nga Bashkimi, por dhe nga të tjerë, madje edhe kur kam folur me Rudinën, ramë dakord që të fillojmë paralelisht të diskutojmë rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, nuk do të çojmë draft në Kuvend, se do t'i diskutojmë dhe do t'i miratojmë në parim. Ka edhe një arsye tjetër, se këto draftet për rekomandimet e OSBE/ODIHR-it do të

shkojnë për ekspertizë tek ODIHR-it, i cili kërkon kohën e vet. Duke miratuar këto paketa përpara si komision, fitojmë dhe i çojmë pjesë-pjesë, marrim opinionin e tyre dhe, në fund, votën e keni ju, keni veton, e pranoni apo nuk e pranoni, pra mund të thoni “Jo, nuk duam”. Por kjo është çështje tjetër, është zgjedhja juaj politike dhe se si do të dalë do ta tregojë koha, sepse politika është dinamike, ka shumë gjëra, megjithatë nuk ka gjë, ju e keni tani mundësinë të thoni jo.

Tani, që të jemi racionalë, duke respektuar edhe njëri-tjetrin, është e rëndësishme të dalim me disa konkluzione. Unë them që grupet e punës të marrin kohë që të përcaktojnë anëtarët dhe t’u lëmë detyrë ekspertëve, që, për çështjet më të thjeshta të vijnë me drafte kur të jenë gati javës tjetër dhe t’i diskutojmë. Të bëjmë edhe një tavolinë të gjerë, ku të vijnë të gjithë aktorët politikë, që edhe ne të jemi transparentë me njëri-tjetrin dhe median dhe të themi që kjo është e pranueshme, kurse ju mund të thoni nesër që jeni dakord, por pa kaluar sistemi kjo nuk kalon. Është e drejta juaj, nuk kam se çfarë të them. Ju e keni mundësinë dhe mërziteni për një gjë që e keni në dorë. Tani do t’ia jap fjalën edhe një anëtar të krahut tim politik

Po, Alket.

Alket Hyseni – Zoti kryetar, është e disata mbledhje që nuk bëjmë asnjë hap para, por bëjmë vetëm retorikë. Më thoni një rresht që kemi miratuar dhe kemi rënë të gjithë dakord? Bëjmë bla bla dhe kjo nuk është dinjitoze për ne, se do të vijë dita që në fund të gjësë, nga presioni, (a i mbani mend ata 140 burra e gra që shkuan e kapën për veshi)... kështu do të na e bëjnë juve dhe neve. Mos u bëni trima sikur nuk e bëni dot! Komisioni ka një procedurë.

(Diskutime pa mikrofon)

Myslim, të lutem, kë ndalova unë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mua, në rregull. Kam 30 vjet unë. Fillove me personale? E ke komplet gabim. Nuk është për trimëri kjo, muhabet kot! Myslim, lërë tani! A di të flasësh politikisht apo, si në katund? Si në katund do të flasim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, prej veshi politikisht. Po qe se nuk je dakord, në rregull. A mund të flas unë deri në fund? Kur flas unë, ndalo, kur të mbaroj, merre fjalën dhe dil kundër! Mësohu me etikë! Mbaj rregull! Unë të dëgjova kur fole ti dhe për 90% të gjërave nuk jam dakord dhe nuk të ofendova e as të pengova.

Do të na kapin thashë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kam ardhur prej veshi unë, se kam 30 vjet që kontribuoj politikisht, kam ardhur me shpatulla.

Të dy bashkëkryetarët harrojnë se kemi bërë një kalendar dhe, ose dilni për zot punës, ose hapini rrugën dy të tjerëve! Ne kemi një kalendar dhe një renditje të çështjeve. Këta zotërinjtë erdhën dhe kërkuan një kompromis, por ne kishim në rend të ditës rekomandimet, shtuam edhe emigrantët, pra e kemi shtuar përpara këtyre zotërinjve, kurse zotërinjtë kërkuan sistemin, atëherë bëmë një renditje kompromisi, se këtu bëhet kompromis se përndryshe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

O Alban, lërë tani, se nuk po bëj politikë, por procedurë!

Kishim rekomandimet si kërkesë e ndërkombëtarëve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, do ta them.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti mos na trash zërin, se nuk ta kemi frikën, por si bashkëkryetare duhet të moderosh e jo të kërcënosh!

Damian Gjiknuri – Zoti Hyseni do të bëjë propozim, mos bëni më asnjë koment!

Alket Hyseni – A do të më lini të flas?

Beni, do të bëjmë muhabet apo punë? Këtu po bëjmë punë. Kemi rënë dakord të gjithë bashkë për agjendën dhe nuk mund të vijmë në mbledhjen e katërt..

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian Gjiknuri – Të lutem!

Alket qëndro në temë!

Alket Hyseni – Në temë jam, por nëse nuk moderoni dot është problemi juaj. Unë po them që ne kemi miratuar këtu që pika e parë të jenë rekomandimet dhe kemi thënë që do ta heqim si pikë, sepse besuam se kjo është pika ku ne biem dakord të gjithë. Pika e dytë ishte për emigrantët, të cilën e kaluam si pikë të tretë dhe thamë që sistemin do ta bëjmë pikë të dytë. Ky është negociimi, ka edhe kompromise për këto gjëra dhe ramë dakord të heqim rekomandimet teknike, sepse ne jemi ata që do të merremi me këtë punë dhe do të biem patjetër dakord. Të kalojmë te pika e dytë dhe ndërkohë kemi fituar kohë, sepse edhe ju do të keni analizuar çështjet e sistemit edhe ne do të analizojmë propozimet tona dhe, në këtë mënyrë, do të arrijmë një pikë. Por ne nuk jemi gati, sepse nuk e kemi pasur dikur fare në rend dite çështjen e sistemit, prandaj hajde të heqim rekomandimet sot. Konkretisht kemi një

tabelë që e kanë sjellë ekspertët. Propozimi im është të ndalemi te rekomandimi nr. 1. Mendoj se nga pikëpamja e formulimeve të KQZ-së ka problematika.

A t'i hyjë konkretisht?

Rudina Hajdari – Zoti Hyseni, i morëm parasysh kritikën tuaj, por në fakt, nuk është asgjë, se bëhet një përmbledhje. Nuk të ka caktuar asnjëri të bësh përmbledhje se çfarë bëhet. Ti nuk ke ardhur të bësh përmbledhje këtu, mund të ikësh nga parlamenti fare, nuk dua të ta shoh më fytyrën!

E para, ndërhyrja e tij nuk ishte me vend, sepse zoti Fino foli shumë drejt kur tha që nuk kemi bërë asgjë, prandaj hajde të ngremë një grup pune, pra po bënte disa kritika me vend dhe, kur janë të tilla, ne i pranojmë. Ndërkohë zoti Hyseni ndërhyri dhe tha që nuk kemi bërë asgjë, por ndërhyrja e tij ishte pa vend dhe jo konstruktive, të jemi të qartë për këtë! As kolegët që ndërhyjnë pa marrë fjalën nuk kanë të drejtë, i thashë edhe zotit Alimadhi që nuk duhet të flasë para zotit Fino, sepse duhet të flasim në mënyrë konstruktive! Zoti Hyseni po ofendonte dhe unë e mbaj ofendimin mbi shpatulla, se nuk e kam problem. Siç zoti Hyseni nuk do të më shohë mua me sy, ashtu dhe unë nuk dua ta shoh atë me sy. Është një ndjenjë reciproke, por jemi këtu për arsye të tjera.

Zoti Fino bëri një propozim konkret. Ne, si grup parlamentar i opozitës duhet të ndajmë punën. Nuk e di a doni ta ndajmë punën sot? Pas kësaj mbledhjeje ne kemi një takim, kështu që i ndajmë pastaj grupet e punës. Pra, kemi rënë dakord për një grup pune për çështjen e sistemit, për rekomandimet e OSBE/ODIHR-it...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino a thamë tri grupe pune?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Elezi, po ndajmë punën se çfarë do të bëjmë.

Damian Gjijnuri - Po u prish rregulli këtu, ne ca jemi me nivel testosteronësh të larta, do të vijmë edhe ca të tjerë nga jashtë dhe nuk do të bëjmë më asnjë bisedë. Kur kemi debate dhe ftohen të gjithë aktorët politikë, do të flasim të gjithë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo Alban, nuk e prish rregullin.

Rudina Hajdari – Ju lutem, a mund të biem dakord për tre grupet e punës, të ndajmë punën, që të kemi të paktën një produkt nga ky takim?

A jeni dakord anëtarë!

Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Të qartësojmë nja dy gjëra, se, mesa shoh, po merremi me të kaluarën. E dimë shumë mirë se kush e ka bllokuar të kaluarën. Unë kam një pyetje për të dy bashkëkryetarët. Ne kemi qenë shumë kërkues për sa i përket frekuencës së takimeve të këtij komisioni dhe produktit që do të nxjerrim. Jam shumë dakord me zotin Fino që çdo gjë dhe çdo angazhim yni në këtë komision duhet bërë mbi bazën e propozimeve konkrete, teknike dhe juridike.

Unë kam një pyetje për ju, zoti Gjijnuri, sepse jemi në mes të tetorit dhe na kërkohet që deri në muajin dhjetor të miratojmë rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, se na i kërkua Perëndia, madje na thuhet edhe “për veshi”, a thua se nuk e dimë se kë kapën për veshi. Pse nuk kemi bërë mbledhje periodike si komision dhe pse është vonuar puna e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it? Edhe zonjës Hajdari ia kam kërkuar disa herë këtë. Unë nuk shoh ndonjë problem me miratimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prit, ta vazhdoj pyetjen se ka edhe një pjesë të dytë.

Si do të procedojmë nga sot e tutje? A do të vendosim për një kalendar javor takimesh me *deadline*, me target dhe me data të qarta se kur do ta japim produktin final?

Damian Gjijnuri – Të lutem, Adnor, në fund! Ta përmbledh pak, meqë m’u bë pyetja dhe të them arsyen.

E thashë që në fillim të mbledhjes, ekspertët kanë bërë një punë. Tradita e Komisionit për Reformën Zgjedhore është traditë pune, nuk është politike, për t’u hedhur poshtë. Produktet që janë gati do të vijnë dhe do të diskutohen. Ne mund të vendosim edhe në tentativë. Pse e them këtë? Se mund të ndodhë që agjenda të ndryshojë dhe çdo të premtë në mëngjes të bëjmë mbledhje.

Ekspertët janë gati dhe brenda një jave të na sjellin çështjet më të thjeshta dhe më pak të debatueshme. Këtë kërkova. Tri grupet e punës që mund të ngrihen janë për çështje që deri diku janë jashtë agjendës së OSBE/ODIHR-it.

Cilat janë çështjet? Vota e emigrantëve, që është çështje specifike, financimi i partive dhe sistemi. Këto tri çështje meritojnë grupe pune, në mënyrë që të punohet paralel. Për pjesën tjetër, hajdeni të vendosim.

Unë e thashë, t’u japim ekspertëve një javë kohë dhe të vijë paketa e parë. Ja, ku e keni paketën e parë, që e thashë që në fillim: barazia gjinore, financimi i zgjedhjeve dhe media. T’i sjellin këto propozime dhe t’i kalojmë. Pastaj kalojmë te pjesa tjetër. Këtë po them.

(Diskutime pa mikrofon)

Këtë po them. Po them të ecim javës tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Propozimet për sistemin duhet t'i sillni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

E thashë që në fillim, ju lutem shumë, të dashur kolegë, sillini propozimet për sistemin! Vendoseni vetë datën dhe mënyrën e propozimit. Datat e tjera nuk varen nga kjo, pra nuk janë të kondicionuara. Arsyeja e vetme pse është vonuar puna, deri diku, është se ju dhashë të drejtë për të trajtuar në fillim çështjen e sistemit dhe për të organizuar debatin me OSBE/ODIHR-in.

Nimet, dua një propozim konkret, që të ecim...

Kush e kishte radhën? Zonja Hysi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lëre, të flasë Nimeti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, a është e mundur për javën tjetër që ju dhe bashkëkryetarja të na thoni se cila do të jetë çështja e rendit të ditës? Të caktohet mbledhja dhe të përgatitemi se cili është grupi i punës që do të punojë nga shumica dhe pakica, që të punojmë gjatë gjithë kësaj jave dhe të fillojmë të prezantojmë pjesë pas pjese propozimet, të marrim në konsideratë çfarë ka thënë shoqëria civile, vëzhguesit vendorë dhe ndërkombëtarë, për çështjen që do të kemi në agjendë. Ndërkohë, të përgatitet edhe mbledhja e javës së dytë, grupi i punës dhe agjenda. Materialet të na i vërë në dispozicion sekretariati.

Kaq kisha.

Damian Gjikhuri – Po ju them që janë tri çështje, që janë më të thjeshta, nuk kanë debate dhe mund të nxjerrim një produkt: barazia gjinore, financimi i zgjedhjeve (këtu mund të ketë edhe debat) dhe media në fushatën zgjedhore.

Ta lëmë në tentativë dhe brenda një jave të kemi një produkt. Do të njoftohemi nga sekretariati, do të vijë drafti dhe do ta diskutojmë. Mbasi të biem dakord me disa gjëra në parim, do ta diskutojmë edhe në një tavolinë më të gjerë, sepse kemi thënë që do të jemi transparentë dhe do t'i ftojme të gjithë aktorët për të dhënë kontributin këtu.

A jeni dakord të vazhdojmë para me këto 3 çështje? Rudina, do të vazhdojmë me këto?

Adriatik Alimadhi – E kam me ju këtë. Në qoftë se ju do ta fusni në proces vazhdimësinë e mbledhjeve të komisionit, unë kam një kërkesë: ose do të operojmë fillimisht me ndryshimet në sistem, pra të bëhemi pjesë e këtij komisioni, ta fillojmë me gangrenën që është bërë fenomen i keq i shqiptarëve, vjedhja e votës, ose na e bëj të qartë, sepse personalisht duhet të mbaj një qëndrim. Nuk mund të vijmë këtu, të na fusin këta në rrugë drejt vathës, të na fusin në shtrungë dhe të bëjmë si të thonë këta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, pse ndërhy, zoti Fino! Kur ndërhyra unë... Mos ndërhy!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po na fusni ne...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ç'lidhje ka kjo? Ky është mendimi im. Na lër tani!

Në qoftë se ju, zonja Hajdari, do të na orientoni se do ta fillojmë procesin e këtij komisioni ashtu siç dakordësuam edhe me dy ambasadorët, jam dakord. Në qoftë se keni qëndrim tjetër, që ta fillojmë me financimin, përfaqësimin e gjinive, këto janë si kofini pas të vjelave. Nuk e di, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ju kam fyer. Po të doni, ju tregoj edhe një histori me gratë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari – Të lutem, jo kërkesa...!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e dëgjova. Çfarë...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Alimadhi, të lutem...!

(Diskutime pa mikrofon)

Damian Gjiknuri – ...e mori Rudina fjalën.

Vazhdo!

Rudina Hajdari – Meqë zoti Alimadhi m'u drejtua për...

Të nderuar deputetë, ne të opozitës do të takohemi më pas dhe do të diskutojmë edhe për atë që u tha gjatë takimit të orës 9:00, edhe për propozimet për ndarjen e grupeve të punës. Në fund të ditës, si bashkëkryetare, kam për detyrë të depozitoj emrat që do të merren me çështjet konkrete.

A jemi dakord me këtë pikë?

Kur dëshironi ta kemi mbledhjen e radhës?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më pas, pra momentin e...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino, të lutem!

Kolegë, duhet të kuptojmë që kjo kërkon punë. Ne duhet të fillojmë të lexojmë mirë çfarë ka nëpër tryezat tona. Nuk duhet të themi thjesht “sistemi” apo diçka tjetër, por duhet të lexojmë vërtet mirë. Edhe për ndryshimin e sistemit grupi opozitar duhet të ketë një propozim konkret. Nëse kërkojmë t’i bëjmë të dyja gjërat ashtu siç thamë edhe në mbledhjen e mëparshme, në të njëjtën kohë, atëherë duhet ta bëjmë propozimin shumë shpejt. Pra, çdo gjë tjetër që keni, duhet ta lini, udhëtimet apo ku ta di unë. Unë po e deklaroj sot që vetëm me këtë do të merrem, që të mos bllokojmë procesin e integritit dhe të mos u pengojmë shqiptarëve të drejtën për të votuar me lista të hapura. Propozoni si e doni ju sistemin, pra jo këtë sistem që është sot, që ne konsiderojmë se ka mbajtur peng vendin. Të biem dakord për një sistem dhe të diskutojmë, por këtë ta bëjmë para dhjetorit. Nëse kërkojmë të ndryshojmë sistemin, duhet ta bëjmë para dhjetorit. Dakord?

Zoti Alimadhi, besoj se e ezaurova edhe pjesën që e kishit me pikëpyetje. E flasim edhe më vonë bashkë, por duhet punë për këtë gjë. Ne kërkojmë shumë, por duhet edhe punë, se nuk mund të kërkojmë dhe të mos bëjmë... Ne nuk themi dot “sistemi” dhe të na e bëjnë këta sistemin. Nuk e bëjnë këta sistemin. Sistemin do ta bëjmë ne. Është detyra jonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, ata kanë mendimin e tyre, por ne e kemi detyrë për ta bërë.

Damian Gjikhuri – Adriatik, meraket politike (Rudina e tha shumë mirë) diskutojini brenda grupit tuaj. E thashë, në fund të fundit, keni një gjë të artë: të drejtën e vetos. E keni këtë. Lërë tani!

E dyta, që të jemi operativë, përveç grupeve të punës, për të cilat me patjetër do të komunikoj me kryetarin, bashkëkryetarin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, se po flas! Nuk ka më. E mbylla atë histori.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, ashtu bëjmë ne. Unë jam një, jam individ, nuk jam shumicë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina, pres emrat e grupeve.

E treta, që të biem dakord, se po humbim kohë kot këtu... Nuk më ka ndodhur ndonjëherë kjo, është hera e parë dhe është turp. Të them të drejtën, nuk ka ndodhur ndonjëherë të bëhet kështu në Komisionin për Reformën Zgjedhore. Diskutohej jashtë kësaj tavoline...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, funksiononte dhe janë bërë shumë kode zgjedhore shumë të mira. Problemi është vullneti politik. Lëri ato tani!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E fundit, kërkoj (ne duhet ta mbështesim, Rudina) që javës tjetër për tri çështjet e para ekspertët të na sjellin draftin, që nuk ka nevojë as për grup pune. Janë 4 pika: amendimet për çështjet e barazisë gjinore, financimi i zgjedhjeve, media dhe përdorimi i burimeve të administratës në funksion të zgjedhjeve. Të lëmë afat.

Do t'ia jap fjalën Nimetit, se e ka kërkuar. Këto janë për herën tjetër. Ndërkohë, duhen emrat e grupeve të punës.

Nimet Musaj – Faleminderit, bashkëkryetar!

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk më vjen mirë për këtë që ndodhi nga kolegët e mi. Nuk më vjen mirë të vazhdojë kjo. Opozita është këtu për të mos u bërë pengesë për integrimin në Bashkimin Europian. Ne jemi këtu dhe duam të japim mendimet tona. Absolutisht, jam dakord që ditën e premte të rimblidhemi në këtë tavolinë.

Kam një pyetje për depolitizimin e KQZ-së dhe administratës. Si dhe ku do të shkojë? Këtë përgjigje e dua ndoshta javën tjetër.

Ne do të sjellim emrat si grup opozitar (nëse do të mblidhemi sot apo nesër, kjo është puna jonë), që kur të vijmë këtu të mos merremi me debate, por me mendime dhe veprime konkrete. Është gjynah për intelektin e gjithsecilit prej nesh të arrijmë në këtë pikë! Është për të ardhur keq! E thashë në mënyrë popullore “gjynah”, se nuk më vjen mirë edhe për tri zonjat që kemi këtu dhe për pjesën tjetër, por edhe për kolegët e mi. Ne duhet të punojmë (e kam fjalën për pjesën e opozitës), të vijmë këtu me propozime konkrete për sistemin dhe gjithçka që kemi. Pastaj vota është jona.

Ju faleminderit!

Damian Gjikhuri – Nimet, faleminderit për propozimin konstruktiv!

Pra, që të jemi brenda agjendës që thamë, 4 çështjet e para mund të kemi mundësinë t'i diskutojmë shumë shpejt. Çështjen e administratës zgjedhore, nivelet, e lëmë si pikë të

dytë dhe ta diskutojmë. Patjetër, ekspertët do të duan më shumë kohë. Kjo është vendimmarrje dhe ne duhet të biem dakord për ta kaluar më tutje.

Pra, pika e parë, amendimet për çështjet e barazisë gjinore, financimin e zgjedhjeve, medien dhe përdorimin e burimeve shtetërore në zgjedhje, janë rekomandime themelore, sidomos përdorimi i administratës.

Duhet të sjellin propozimet ekspertët dhe ne do të diskutojmë për hapin tjetër, nëse do t'i konsultojmë publikisht (unë them se duhet ta bëjmë) mbase në një tavolinë më të gjerë, por mbasi t'i kemi diskutuar këtu.

Së fundi, kam edhe një njoftim, që e kam merak: ODIHR-i do të bëjë një prezantim javën tjetër dhe ne mund t'i kombinojmë të dyja mbledhjet (mbase edhe ekspertët nuk do të jenë gati), do të bëjë prezantimin e të gjitha rekomandimeve, përfshirë edhe raportin e fundit për zgjedhjet vendore dhe këtë do ta bëjnë me Komisionin për Reformën Zgjedhore. Në mos gaboj, është në datën 15. Çfarë dite është data 15?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, ditën e martë.

Nuk do të ketë ndonjë vendimmarrje, se është më tepër informative, por është mirë që një pjesë e komisionit të jetë. Unë patjetër që do të jem, edhe bashkëkryetarja. Do të jetë prezantimi i të gjitha gjetjeve të konsoliduara gjatë viteve, në atë mënyrën që janë edhe pjesë e punës së Komisionit për Reformën Zgjedhore.

A biem dakord me këtë, që të ecim dhe të mos i kthehemi? Vazhdojmë, Rudina? A jemi dakord? Datën do ta përcaktojmë ne të dy kur të jenë të gjithë anëtarët, se disa janë jashtë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për datën e mbledhjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, për datën e...

U mor ky vendim. Jemi dakord që ekspertët të na sjellin këtu pika.

Ju lutem, kur të jemi gati, e mira është t'i lëmë disa ditë para gjithë anëtarëve të komisionit dhe pastaj të vijnë dhe të bëjnë...!

Atëherë, faleminderit shumë!

Rudina Hajdari - Kam edhe një gjë të fundit. Duhet të mundohemi që të paktën (diskutojeni edhe ju me grupin tuaj, zoti bashkëkryetar) të gjejmë një mënyrë komunikimi më të drejtë, sepse kjo mënyrë nuk përballohet dot psikologjikisht. Jemi të lodhur, kemi shumë

punë të tjera dhe nuk do t'i konsumojmë të gjitha energjinë... Për çfarë?! Ju lutem shumë, flisni me njëri-tjetrin dhe gjeni një gjuhë komunikimi! Edhe ne do të flasim me njëri-tjetrin, që të kemi një rregull këtu. Përndryshe po kaluam në ofendime, nuk...

Po të na shikojë dikush nga jashtë duke folur me njëri-tjetrin në këtë lloj mënyre, është...

(Debate pa mikrofon)

MBYLLET MBLEDHJA